

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KOMUNA E KAMENICËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **653-25-8696-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Ndërtimi i transformatorit me SN-400KvA**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>RISAMONT SH.P.K.</b>
NUI	<b>811273424</b>
Adresa	<b>Rr. Brahim Ademi, B.Diellit</b>
Vendi	<b>Prishtinë</b>
Kodi postar	<b>10 000</b>
Numri Telefonit	<b>049393582</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Riad Rexhepi</b>
Adresa elektronike	<b>risamont@gmail.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>08.05.2026</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

#### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Ndërtimi i transformatorit me SN-400KvA**

**Njoftimi për Kontratë: 25.09.2025**

**Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 15.10.2025**

**Njoftim mbi vendimin e AK-së: 20.11.2025**

**Kërkesa për rishqyrtim dt.24.11.2025**

**Ankesa dt.08.12.2025**

**Ekspertiza e OSHP-së dt.15.12.2025 Nr.2025/1212**

**Vendimi i OSHP-së dt.26.01.2026 nr. 2025/1212**

**Njoftim mbi vendimin e AK-së: 22.04.2026**

**Kërkesa për rishqyrtim dt. 27.04.2026**

**Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt:30.04.2026**

#### **4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

Jo

#### **5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

Jo

#### **6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

Jo

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë contestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**Bashkëngjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.**

## **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 1 i LPP-së**

**Neni 6 i LPP-së**

**Neni 7 i LPP-së**

**Neni 59 i LPP-së**

**Neni 60 i LPP-së**

**Neni 69 i LPP-së**

**Neni 72 i LPP-së**

**Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Me datën 22.04.2026 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE “ELEKTRO DIARI SH.P.K. & EL-BAU SH.P.K., ndërsa ne jemi shpallur tenderues të eliminuar më arsyetimin:

**Arsyet për refuzimin e tenderit të juaj janë të bazuara në arsyet e renditura si në vijim:**

**RISAMONT SH.P.K.-** Pas vendimit të OSHPse- me numer 2025/1212 ne si komision kemi kerkua sqarime shtese dhe sa i perket pajisjeve duke respektuar vendimin e OSHP-se komisioni i merre si mireqena . Per menaxherin e projektit z. Arben Fejzullahu licensa eshte ne rregull ndersa sa i perket in te ndertimtarise z. Faton Musolli licensa eshte marrur pas dates se dorezimit te tendereve . O. Risamont ka dorezuar oferten me date 15.10.2025 ndersa ing eshte licensuar ka oda e inxhinierëve m date 21.10.2025 dhe pas sqarimeve O.E ka bashkangjitur nje email ku licensuar i eshte dorezua kompanise me date 21.11.2025 .

Per kete pike oferta duhet te refuzohet pasi qe bie ndesh me nenin 72 te Ligjit per prokurimin publik Neni 72 paragrafi 3 Dokumentacioni dhe informacini shtese: Sigurimi i informacionit qe mungon ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.  
Bazuar ne kete dispozite dokumenti eshte marrur pas dates se dorezimit dhe oferta duhet te refuzohet.

Ju sqarojmë se arsyeja e eliminimit tonë është e paqëndrueshme për arsyet si në vijim:

Fillimisht, sqarojmë se ky aktivitet i prokurimit ka qenë edhe njëherë në OSHP dhe në ankesën e dt. 08.12.2025 e kemi bashkangjit edhe licencën e inxhinierit Faton Musolli, e që më pastaj edhe eksperti shqyrtues e edhe paneli shqyrtues e ka detyruar AK-së të kërkojë sqarime shtesë në lidhje me këtë licencë.

Pas vendimit të OSHP-së, gjatë rivlerësimit, neve na janë kërkuar sqarime shtesë nga ana e autoritetit kontraktues në lidhje me licencën e inxhinierit të ndërtimtarisë z. Faton Musolli. Ne, me sqarime shtesë e kemi prezantuar licencën e inxhinierit z. Faton Musolli. Sipas dokumentit zyrtar të lëshuar nga Oda e Inxhinierëve, shihet qartë se vendimi për licencimin e inxhinierit është marr me vendimin nr. 800/25, me datë 07.10.2025, prandaj kjo datë është datë zyrtare e licencimit dhe ky fakt duhet të merret parasysh nga institucionet tjera dhe nga autoriteti kontraktues.

Data e lëshimit fizik të licencës, të cilës i është referuar autoriteti kontraktues 21.10.2025, nuk mund dhe nuk është dashur të merret si datë e licencimit, për faktin se kjo datë tregon/prezanton datën e lëshimit të dokumentit në kopje fizike, dhe jo momentin kur është fituar e drejta për ushtrimin e profesionit, përkatësisht momentin kur është licencuar inxhinieri.

Në këtë rast data reale e licencimit, e që duhet të merret për vlerësim është data e vendimit për licencim (07.10.2025), pasi me këtë vendim organi kompetent ka konfirmuar përmbushjen e të gjitha kushteve ligjore për licencim, përkatësisht në këtë datë inxhinieri është licencuar dhe e ka fituar të drejtën të punojë me këtë licencë. Lëshimi i dokumentit fizik në një datë të mëvonshme është vetëm procedurë teknike dhe administrative, e cila nuk e ndryshon statusin juridik të personit të licencuar, prandaj edhe arsyetimi i autoritetit kontraktues për eliminimin e kompanisë tonë nga aktiviteti i prokurimit është i pa bazuar dhe tendencioz.

Vendimi për licencim me dt.07.10.2025 është vendim përfundimtar dhe akt themelor administrativ, ku me këtë vendim, inxhinierit në fjalë i është lejuar dhe i është njoft e drejta për ushtrim të profesionit me licencë, ndërsa data e lëshimit të licencës nuk tregon

për aktin themeltar dhe plotësimin e kushteve për licencim por thjesht është një dokument i cili e formalizon të drejtën e fituar me vendimin e dt.07.10.2025.

Referimi i autoritetit kontraktues tek neni 72 paragrafi 3 i LPP-së, është i paqëndrueshëm, sepse dokumenti i dorëzuar nga ana jonë është dokument, ekzistenca e të cilit është e fiksuar dhe mund të vërtetohet shumë qartë në mënyrë objektive. Dokumenti apo licenca e lëshuar bazohet në një vendim të marr para afatit të dorëzimit të ofertave dhe fakti se inxhinieri është licencuar para datës së ofertimit vërtetohet objektivisht kur analizohet licenca, e ku në preambulë shënohet se licenca lëshohet bazuar në vendimin e komisionit vlerësues me numër 800/25 të dt.07.10.2025, prandaj kjo datë është data reale e licencimit, pasi që me këtë datë është vlerësuar se inxhinieri i ka plotësuar kushtet për licencim.

Çështja e lëshimit të licencës është çështje administrative dhe teknike, prandaj nuk duhet të diskriminohemi ne si kompani në këtë rast dhe nuk duhet të lejohet dëmtimi i buxhetit për këtë çështje teknike dhe minore.

Pra, në mënyrë objektive vërtetohet ekzistenca e të drejtës së fituar me vendimin e dt.07.10.2025, pra e drejta për të punuar si inxhinier i licencuar. Prandaj konform nenit 72 të LPP-së oferta jonë është e përgjegjshme. Për më tepër, autoriteti kontraktues ka mundur edhe drejtpërdrejtë të kërkojë sqarime edhe nga Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës për të vërtetuar se kur është nxjerr/marr vendimi për licencim për inxhinierin Faton Musolli, madje ne e kemi inkurajuar që ta bëjë një gjë të tillë, mirëpo autoriteti kontraktues nuk ka shpreh gatishmëri që të merr informacione të tilla zyrtare.

Për ta bërë më të qartë edhe për autoritetin kontraktues në vijim po e ilustrojmë me një shembull këtë rast. Kjo situatë është e njëjtë sikur një student që ka përfunduar të gjitha provimet dhe ka diplomuar, dhe nuk arrin ta marr diplomën kopje fizike menjëherë për shkak të procedurave administrative. Në praktikë, data e kryerjes së provimeve llogaritet datë e diplomimit, e nuk konsiderohet data e lëshimit të diplomës datë e diplomimit. Edhe në këtë rast të ilustruar, personi që i ka përfunduar provimet mund të ushtrojë profesionin dhe të punojë që nga ajo datë e jo nga data e marrjes së diplomës.

Edhe në këto raste shkruan në diplomë, se studimet i mbaroj me datën e caktuar apo provimet i mbaroi me datën e caktuar.

Çështja e datës së shënuar në certifikatë është devijim i vogël sipas nenit 59.4 pika (ii), pasi që nuk mund të shkaktojë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, prandaj duhet të merret parasysh nga ana e autoritetit kontraktues.

Kompania jonë në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit për një gjë të tillë, përderisa inxhinieri i prezantuar është licencuar para datës së hapjes së ofertave, pa marr parasysh faktin se kur është lëshuar licenca në kopje fizike.

Kur kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet se ne si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët në këtë aktivitet të prokurimit, jemi diskriminuar nga ana e AK-së, prandaj kërkojmë që të bëhet rivlerësimi i ofertave edhe një herë dhe pastaj të nxjerret një vendim meritore në lidhje me ofertën tonë duke e konsideruar ofertën tonë të përgjegjshme.

Ne me dt.30.04.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për

rishqyrtim, ku AK-ja e ka cilësuar të njëjtën si të pa bazuar, mirëpo që AK-së nuk ka dhënë arsye konkrete për një refuzim të tillë.

AK-ja është arsyetuar si në vijim:

Sa i përket pretendimit lidhur me licencën e inxhinierit të ndërtimtarisë z. **Faton Musolli**, Komisioni ka konstatuar se oferta e OE "RISAMONT SH.P.K." është dorëzuar me datë **15.10.2025**, ndërsa licenca profesionale e paraqitur është lëshuar nga organi kompetent me datë **21.10.2025**. Rrjedhimisht, në momentin e dorëzimit të ofertës, dokumenti i kërkuar nuk ka ekzistuar si dokument i vlefshëm dhe i verifikueshëm.

Pretendimi se duhet të merret për bazë data e vendimit të brendshëm administrativ për licencim (**07.10.2025**) nuk mund të pranohet, pasi në procedurat e prokurimit publik vlerësohen vetëm dokumentet zyrtare të dorëzuara dhe të verifikueshme, e jo pretendime apo interpretime mbi akte të brendshme administrative që nuk janë paraqitur si dokument i vlefshëm në momentin e ofertimit. Gjithashtu vlen të potencohet se personi që keni paraqitur ju si person i licensuar nuk ka poseduar license me rastin e ofertimit por bazuar në dokumentet e dorëzuara i njejtë nuk ka paraqitur ndonjë dokument tjetër që verteton se i njejtë ka qene i licensuar me rastin e ofertimit . Dokument relevant në këtë rast është licenca e lëshuar nga organi kompetent, e cila mban datën **21.10.2025**.

Në përputhje me **nenin 72 paragrafi 3 të Ligjit për Prokurimin Publik**, përcaktohet se:

*“Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.”*

Në rastin konkret, dokumenti i kërkuar nuk ka qenë i lëshuar para afatit të dorëzimit të ofertave, andaj nuk mund të pranohet përmes sqarimeve shtesë pas afatit. Çdo pranim i një dokumenti të krijuar pas afatit do të përbënte ndryshim material të ofertës dhe trajtim të pabarabartë ndaj operatorëve ekonomikë të tjerë.

Po ashtu, pretendimi se kjo paraqet “devijim të vogël” sipas nenit 59.4 nuk qëndron, pasi licenca profesionale e stafit të kërkuar është kriter thelbësor i kualifikimit dhe jo mangësi teknike apo formale. Mungesa e një licence të vlefshme në datën e ofertimit ndikon drejtpërdrejt në përgjegjshmërinë e ofertës.

Pretendimet lidhur me nenin 7, nenin 1 dhe nenin 60 të LPP-së janë gjithashtu të pabazuara, pasi kriteri i çmimit më të ulët zbatohet vetëm pasi oferta të jetë vlerësuar fillimisht si e **përgjegjshme** dhe në përputhje me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Një ofertë që nuk plotëson kriteret e kualifikimit nuk mund të rekomandohet për kontratë vetëm për shkak të çmimit më të ulët.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë të barabartë, transparente dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke aplikuar të njëjtat standarde për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetimi i AK-së për refuzimin e kërkesës sonë nuk qëndron, pasi që AK-ja ka marrë si referencë datën e lëshimit fizik të licencës (21.10.2025), duke e cilësuar atë si datë të licencimit, ndërsa siç edhe e kemi sqaruar më lartë kjo datë tregon vetëm momentin e lëshimit të dokumentit në formë fizike. Licencimi i inxhinierit të prezantuar nga ana jonë është bërë me vendimin e organit kompetent me datë 07.10.2025, me të cilin është konstatuar përmbushja e kushteve dhe është fituar e drejta për ushtrim të profesionit. Nga ky fakt kuptohet se në momentin e dorëzimit të ofertës, inxhinieri ka qenë i licencuar dhe kjo e drejtë ka ekzistuar realisht, pra arsyetimi i autoritetit kontraktues ku e ka shënuar se në procedurat e prokurimit vlerësohen vetëm dokumentet zyrtare të dorëzuara dhe të verifikueshme, nuk qëndron.

Në licencë shënohet qartë si në vijim:

Në përputhje me nenin 26 të Ligjit Nr.08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, nenet 5,7,8,9 dhe 11 të Rregullores për Procedurën e Licencimit, Rilicencimit, Mirëmbajtjen, Pezullimin dhe Revokimin e Licencës së Inxhinierit të Licencuar të Odës me numër protokoli 8651/24 të datës 31.12.2024 dhe bazuar në Vendimin e Komisionit Vlerësues me numër 800/25 të datës 07.10.2025, Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, lëshon:

Kur kemi parasysh këtë fakt autoriteti kontraktues me qëllim të respektimit të kërkesave të dosjes së tenderit dhe mos dëmtimit të buxhetit të shtetit ka mundur të kërkoj sqarime shtesë direkt nga Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës. Pasi të kërkoreshin sqarimet shtesë do të vërtetohej shumë lehtë se pretendimi ynë ankimor është i bazuar, por që një veprim të tillë e njëjta nuk e ka bërë duke na diskriminuar neve si OE të përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë.

Nje vertetim i tille munde te behet edhe nga licenca e menaxherit te projektit ku licenca barte daten e vendimit per licencim, pra:

Në përputhje me nenin 26 të Ligjit Nr.08/L - 012 për Odat e Artë të  
Fushën Ndërtimit, nenet 5,7,8,9 dhe 11 të Rregullores për Procedurën  
Mirëmbajtjen, Pezullimin dhe Revokimin e Licencës së Inxhinierit të  
protokoli 8651/24 të datës 31.12.2024 dhe bazuar në Vendimin e Komitetit të  
458/25 të datës 25.06.2025, Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës

---

# LICENCA A

---

**INXHINIER I LICENCUAR**

**ARBEN FEJZULLA**

**Titulli akademik: Master i Shkencave të Inxhinierisë  
Drejtimi: Elektroenergjetikë Industriale**

**Data e lindjes: 29.06.1982**

**Numri i licencës: E-0229**

Arsyetimi i AK-së se inxhinieri në fjalë nuk ka pasur licencë në momentin e ofertimit është i pa bazuar, sepse licenca e dorëzuar nga ana jonë me sqarimet shtesë tregon qartë një të drejtë që ka ekzistuar para datës së dorëzimit të ofertave dhe se e njëjta është e bazuar në vendim konkret me datë të qartë të licencimit. Pra nëse analizohet në detaje licenca, nga vetë përmbajtja e licencës shihet referimi që i është bërë vendimi të Komisionit Vlerësues me nr.800/25, dt.07.10.2025, fakt ky që e bën lehtësisht të verifikueshme në mënyrë objektive kohën e licencimit.

Pretendimi i AK-së se në momentin e ofertimit nuk ka qenë ndonjë dokument që vërtetonte se ka qenë i licencuar inxhinieri në fjalë është pretendim i pa bazuar dhe jo profesional, sepse edhe nëse nuk do të ishte ndonjë dokument siç pretendon AK-së atëherë konform nenit 10 të UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, është dashur të kërkohen sqarime shtesë.

Autoriteti kontraktues në vendimin e tij për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, tregon qartë edhe një herë diskriminimin që po i bën kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë, pasi që e njëjta edhe në njoftimin mbi vendimin e parë na kishte eliminuar me arsyetime krejtësisht të paqëndrueshme.

Për më tepër, AK-ja nuk ka bërë verifikim të plotë të fakteve të prezantuara nga ne, por është mjaftuar me një interpretim sipërfaqësor të dokumentit.

**Pikërisht për këtë arsye, kërkojmë nga eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues i OSHP-së të kërkojnë sqarime zyrtare direkt nga Oda e Inxhinierëve lidhur me datën e nxjerrjes së vendimit për licencim, ku do të vërtetohet pa asnjë dilemë se licencimi ka ndodhur para datës së ofertimit.**

Si përfundim vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pabazuar dhe jo profesional, prandaj kërkojmë nga OSHP-ja që edhe këtë vendim mos ta merr parasysh, pasi që një vendim të tillë ne e shohim si tendencioz kundrejt kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën tonë, prandaj duhet rishqyrtuar edhe njëherë ky aktivitet i prokurimit me të gjitha dëshmitë e ofruara.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse nuk jemi rekomanduar për kontratë edhe pse jemi OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë se sa OE i rekomanduar për kontratë për 4,314.70 euro.**

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë, ndërsa ne edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe jemi me çmim më të lirë, nuk jemi shpall fitues i këtij tenderi.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

## VENDIM

**APROVOHET**, si e bazuar ankesa e OE **Risamont SH.P.K-Prishtinë**.

**ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim dhe ankesës në vlerë prej të paktën 5,000.00 euro.**

#### **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*